



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4 / I40-2 Prot.
Nr. Dok. 202502739/2

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e shtetasve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/Komisariatën e Policisë në Vlorë

Drejtuar: Z. Elidon ÇELA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë

VLORE

Z. Elvis PEZA
Shef i Komisarariatit të Policisë Vlorë

VLORE

Për dijeni: Z. Ilir PRODA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatën e Policisë Vlorë në datën 09.05.2025.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar kreu këtë inspektim në Komisariatën e Policisë Vlorë. Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. Urdhër 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e një viti më parë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë në Vlorë z. Elidon Çela dhe Shefin e Komisarariatit të Policisë në Vlorë z. Elvis Peza, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me respektimin dhe trajtimin e shtetasve gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e Komisarariatit në cilësinë e të shoqëruarve dhe të ndaluarve/arrestuarve, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve ndërkombëtare për këtë qëllim, plotësimin e kushteve në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm të zhvilluar në datë 05.03.2024.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me përgjegjësën e dhomave të sigurisë dhe punonjësën e zyrës së informacionit të dhomave të shoqërimit, inspektoi mjediset ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, verifikoi dhe administroi dokumentacionin që plotësohej prej punonjësve të policisë sipas procedurave standarde, vizitoi zyrat e specialistëve të policisë të këtij institucioni që kryejnë veprime proceduriale me shtetasit e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe zhvilloi intervista konfidenciale me personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, në lidhje me respektimin e të drejtave dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave.

Lidhur me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar, rezultoi se **nuk ishin realizuar** rekomandimet e mëposhtme¹:

- për ndërtimin sa më parë në Komisariatin e Policisë Vlorë të ambientit të ri të dhomave të sigurisë, sipas kushteve e kriterëve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare, me qëllim shtimin e numrit të dhomave të sigurisë, rritjen e kapaciteteve akomoduese për të ndaluar/arrestuarit dhe përmirësimin e kushteve e trajtimin dinjitoz të këtyre personave dhe shmangien e mbipopullimit në këto ambiente;

¹ Rekomandim, nr. K4/I15-2 prot. datë 25.06.2024, “Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e shtetasve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/ Komisariatin e Policisë në Vlorë”

- për përshtatjen e një dhome më vete brenda sistemit të dhomave të sigurisë, për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar, e cila të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive;
- për instalimin e butonave/zileve në dhomat e sigurisë ekzistuese, për njoftimin e personelit të shërbimit në rast nevojë nga personat e ndaluar/arrestuar, nisur nga ngjarjet që kanë ndodhur në disa komisariate policie (komisariatet e policisë Kamëz dhe Kavajë në DVP Tiranë) gjatë vitit 2022 me pasojë vdekjen e personave;
- për krijimin e një ambienti brenda sistemit të dhomave të sigurisë, i cili të shërbejë si vend i posaçëm ajrimi për të ndaluarit/arrestuarit.

Ishte zbatuar rekomandimi si më poshtë:

- për konsultim me Dhomën e Avokatëve për t'u siguruar që avokatëve kryesisht t'u kujtohet roli i tyre kyç për të qenë të pranishëm në Komisaratin e Policisë në Vlorë dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë.

Ndërkohë, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nëpërmjet shkresës Nr. 6288/1prot, datë 20.08.2024 na bën me dije se: *“Lidhur me rekomandimet për ndërtimin në Komisaratin e Policisë Vlorë të ambientit të dhomave të sigurisë, nga DPPSH do të shihet mundësia e planifikimit të fondeve në PBA 2025-2027 për Studim-Projektimin e hartimit të projektit të zbatimit për ndërtimin e objektit të ri-shtesë anësore, me qëllimin e shtimit të kapaciteteve akomoduese (madhorë, femra të mitur), krijimin/ndërtimin e ambienteve të intervistimit/ marrjes në pyetje, paraqitje për njohje, intervistimi i të miturve me ndriçim natyral dhe sipërfaqe normale, të pajisura me ndriçim, sistem monitorues me kamera, pajisje audio- vizive, sistem ngrohje ftohje konform rekomandimeve të Avokatit të Popullit”.*

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Vlorë ishte ndërtuar i ri dhe përmbushte përgjithësisht kriteret e përcaktuara në procedurën standarde të punës *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*².

Ky ambient ishte ndërtuar ngjitur me ambientin ku ndodhen dhomat e sigurisë të komisarariatit, në një nga godinat që ndodhen brenda territorit të DVP-së Vlorë.

Ambienti kishte 3 dhoma shoqërimi të ndara më vehte për të rriturit burra, gratë dhe të miturit. Përmasat e dhomave ishin 3x4 m², me hapësirë dhe sipërfaqe për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona të shoqëruar në secilën dhomë. Dhomat ishin të

² Kreu VII *“Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar”* pika 2, 3, 4 dhe 5 i procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”*.

pajisura me stola me këmbë të fiksuara ne dysHEME, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Mjediset ishin të pastra nga ana higjienike si dhe kishin dritare me përmasa të tilla që krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Dritaret ishin të siguruara me skarë hekuri, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga mjediset e komisariatit. Tualetet ndodheshin brenda dhomave të shoqërimit (pa cenuar sipërfaqen e dhomës së shoqërimit), ato ishin të pastra dhe kishin ujë të rrjedhshëm.

Ndërkohë, në ambientet e DVP-së Vlorë kishte mjedis më vete *“Njësia për mbrojtjen e grave viktime të dhunës në familje dhe kundër trafikimit të qënieve njerëzore”*, ambient i cili shërbente njëkohësisht edhe për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Ky mjedis përbëhej nga dy dhoma, një dhomë për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar gra dhe të mitur, si dhe një dhomë që përdorej për intervistimin e tyre nga punonjësit e policisë të trajnuar për këtë qëllim, në prezencë të kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës për rastin e të miturve. Përmasat e dhomave ishin 4x3 m² dhe kapaciteti i tyre ishte për 5 persona. Këto dhoma ishin funksionale dhe të kompletuara me orenditë e pajisjet e nevojshme për qëndrimin ulur dhe në kushte komode pune për punonjësit e policisë, gjatë procesit të marrjes në pyetje të grave dhe të miturve në konflikt me ligjin. Ato kishin sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme, si dhe dritare që mundësonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Këto dhoma ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

DVP Vlorë në kuadër të *“Njesisë për luftën kundër dhunës në familje dhe trafikimit të qënieve njerëzore”*, kishte një bashkëpunim të mirë me Qendrën *“Vatra”*, e cila trajton dhe strehon gratë e vajzat, të evidentuara gjatë procesit hetimor nga punonjësit e policisë si viktime të mundshme të trafikimit, me qëllimin e ri-integritimit të tyre në shoqëri.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë të veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Njëkohësisht edhe kryerja e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe komunikimi i masës së sigurisë të personave për kalimin nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, kryhej në zyrat e punës së punonjësve të policisë.

Një nga problematikat e evidentuara e cila është trajtuar edhe më herët nga Avokati i Popullit është mungesa **e dhomave të intervistimit/marrjes në pyetje të personit në cilësinë e të shoqëruarit, të arrestuarit apo të ndaluarit, brenda mjediseve të Policisë së Shtetit.**

- a) Në komisariatet e policisë, ka mungesë të dhomave më vete për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/ndaluar/ arrestuar që duhet të ndërtohen në këto mjedise;
- b) Mungon instalimi i pajisjeve të sigurisë audio-vizive për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit.

Në Procedurën Standarde të Punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, me Urdhrin: nr. 894, dt. 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet qartë se: *Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).*

i.1.1 Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte:

Të ketë të instaluar tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).

Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.

Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar³ në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim mbetet masivisht i pa plotësuar. Po ashtu Avokati i Popullit vlerëson se përmirësimet në lidhje me këtë çështje janë të papërfillshme nga një vit në tjetrin.

Dhomat dhe korridori në mjedisin e shoqërimit monitorohej nga sistemi i kamerave, Administrimi i kamerave kryhej nga specialistët e IT-së në Drejtorinë e Policisë Vlorë. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë.

Në komisariatit të Policisë Vlorë ishin të punësuar 12 oficerë të policisë gjyqësore, nga monitorimi që iu bë zyrave të punës, nuk u konstatuan sende apo pajisje që të ekspozonin dhunë psikologjike ndaj personave të shoqëruar kur merreshin në pyetje prej tyre, provat materiale të cilat gjendeshin në këto zyra ishin të mbyllura në çanta (qeska), si dhe të ishin të individualizuara⁴.

³ Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së shtetit. Nr.K4/I15-2Prot. Datë 25.06.2024.

⁴Neni 215 i K.Pr.P “Ruajtja e sendeve të sekuestruara”.

Në ambientet brenda dhe jashtë dhomave të shoqërimit, ishin të afishuara karta me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit. Gjithashtu përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia **ju jepej informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore**, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisariat . Rekomandimi i MKPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet tu jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Në momentin e inspektimit, nuk ndodhej asnjë person i shoqëruar në këto ambiente. Nga verifikimi i regjistrimit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, për periudhën Janar – Prill 2025, ishin shoqëruar në këto mjedise 282 persona, nga të cilët 67 të mitur.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, ishte përgjithësisht i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ky ambient ndodhej në katin e parë të një prej godinave brenda territorit të Komisarimit të Policisë Vlorë. Ai përbëhej nga 6 (gjashtë) dhoma sigurie, të ndara në 4 (katër) dhoma për persona burra, 1(një) dhomë për gratë dhe 1(një) dhomë për të mitur.

Dy nga dhomat sigurie së të rriturve në Komisaratin e Policisë Vlorë vazhdonin të qëndronin të mbyllura pasi në vijim të monitorimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ato nuk i përmbushnin standardet e sigurisë dhe trajtimit.

Aktualisht funksionale ishin 4 dhoma sigurie të ndara 2 dhoma për burra një për gra dhe 1 për të mitur, dhomat ishin të plotësuara me shtretër dhe kishin kapacitet për mbajtjen, akomodimin e trajtimin e 6 personave.

Por, nisur nga fakti se DVP Vlorë mbulon një qark të rëndësishëm nga pikëpamja e territorit dhe numrit të popullsisë, ka fluks të lartë të njerëzve që frekuentojnë këtë zonë gjatë gjithë vitit, si dhe faktit se në këto dhoma sigurohen persona të ndaluar dhe të arrestuar edhe nga punonjësit e komisarimit të policisë Himarë dhe stacionet e policisë Orikum dhe Selenicë, **numri i dhomave të sigurisë ekzistuese dhe kapaciteti i tyre konsiderohet shumë i ulët dhe për këtë shkak mbipopullimi në këto dhoma është i vazhdueshëm.**

Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se është e domosdoshme rritja e numrit të dhomave të sigurisë dhe e kapaciteteve

akomoduere në komisariatit e policisë Vlorë, me qëllim garantimin e kushteve dhe trajtimin dinjitoz të personave të arrestuar apo të ndaluar.

Në momentin e inspektimit, u konstatua se në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 persona të arrestuar, në moshë madhore. Nga verifikimi i regjistrit për personat e ndaluar/arrestuar që ndodhej në ambientin e sigurisë, rezultoi se, për periudhën janar–prill 2025 ishin evidentuar të dhënat për 171 persona të arrestuar/ndaluar.

Dhomat e sigurisë ishin të kompletuara me krevate dhe materiale për fjetje si dyshek, batanije dhe jastëk. Materialet e fjetjes për personat e ndaluar/arrestuar mbaheshin në një magazinë dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë. Por nga inspektimi konstatuam se këto ambiente kanë nevojë për lyerje dezinfektim dhe mirëmbajtje.

Dritaret e dhomave të sigurisë **ishin me përmasa të vogla, ndaj nuk mundësonin ajrim** dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm për shikim dhe lexim të ndaluar/arrestuarve.

Në dhomat e sigurisë kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje të energjisë elektrike, kishte gjenerator që shërbente si burim rezervë për furnizimin me energji elektrike.

Në ambientin e sigurisë ndodheshin pesë tualete, nga të cilat dy ishin brenda dhomave (dhoma për gra dhe dhoma për të mitur) dhe një tualet i përbashkët që ndodhej në korridor bashkë me ambientin e dushit. Këto ambiente ishin të kompletuara me pajisje hidrosanitare dhe çezma me rubinet, që furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm për 24 orë. Në ambientin e dushit kishte një bolier për ngrohjen e ujit, që shërbente për larjen e trupit të personave të arrestuar/të ndaluar.

Komisariati i Policisë Vlorë **nuk ka sistem qendror për ngrohje/ftohje**. Sipas informacionit, ngrohja e ambienteve sigurohej me pajisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Veç dhomave të sigurisë, në korridorin e ambientit të sigurisë kishte 1(një) dhomë e cila kryente disa funksione si dhomë e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, dhomë për marrjen në pyetje/intervistimin e të ndaluarve/ arrestuarve nga OPGJ/prokurorët e çështjes, për takime me avokatët mbrojtës. Kjo dhomë kishte një krevat, një tavolinë pune, një karrige dhe disa raftë për mbajtjen e dokumentacionit. Dhoma shërbente njëkohësisht edhe si magazinë për mbajtjen e materialeve që i nevojiteshin përgjegjësit të dhomave të sigurisë për furnizimin e personave të ndaluar/arrestuar me materiale për qëndrim dhe jetesë normale.

Kjo dhomë, përtej funksioneve që kryente, konstatohet se **nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në procedurën standarde për ndërtimin e dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë**.

Konkretisht, dhoma për zhvillimin e procesit të marrjes në pyetje dhe e kryerjes së veprimeve të tjera procedurale me të arrestuarit/ndaluarit, duhet të jetë dhomë e veçantë brenda sistemit të dhomave të sigurisë. Përmasat e kësaj dhome duhet të jenë jo më pak se 4m x 4m dhe orenditë që vendosen në këtë dhomë si tavolina pune e karrige për të qëndruar ulur e punuar përfaqësuesit e organit të akuzës (oficer i policisë gjyqësore apo prokurori), avokati mbrojtës/përfaqësuesi ligjor, si dhe i ndaluari/arrestuari, duhet

të jenë të ndërtuara prej materiali druri dhe të fiksuara në dysHEME në mënyrë të palëvizshme e të pa çmontueshme lehtësisht⁵.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ishte i instaluar një telefon fiks, i cili shërbente në rastet urgjente për njoftimin e zyrës së informacionit nga punonjësit e policisë që shërbenin në këtë ambient.

Në vazhdimësi konstatojmë se në dhomat e sigurisë mungon një buton me zile/sinjali në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.

Në pjesën e jashtme dhe në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte të instaluar kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti.

Sipas informacionit të mbledhur, në rastet kur personat e ndaluar/arrestuar ishin shtetas të huaj, zbatohet menjëherë procedura për njoftimin e përfaqësive diplomatike të vendeve të tyre, si dhe pajiseshin me kartën e të drejtave në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë. Pajisja me avokat mbrojtës dhe përkthyes në gjuhën e tyre, është një detyrim ligjor dhe duhet të plotësohet domosdoshmërisht. Referimet e rasteve pranë avokatëve mbrojtës dhe përkthyesve, kryhen nga specialistët e policisë (opgj) që marrin në pyetje këta shtetas, duke marrë për bazë listat e miratuara të avokatëve dhe përkthyesve, që disponohen prej tyre. Në përgjithësi, nga verifikimi i regjistrave avokati mbrojtës dhe përkthyesi ishin siguruar nga familjarët dhe të njohurit e këtyre personave.

Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë ndodhej karta e të drejtave të shtetasve të privuar nga liria, e përkthyer në 10 gjuhë të huaja më kryesore.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatit e Policisë Vlorë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”⁶.

Të gjithë personat e shoqëruar, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, ai ishte i plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë.

Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryhet nga oficeri/agjenti i policisë gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit është jo më tepër se 12 orë.

⁵Kreu VII, pika 7 e procedurës standarde “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

⁶ Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, kreu VIII “Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit”, pika a.1.2, “Regjistri i evidentimit të personave të shoqëruar”.

Në zyrën e informacionit të Komisarariatit, ishte regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të mitur, në bazë dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim⁷. Për periudhën janar-prill 2025 ishin evidentuar të dhënat për 3 të mitur.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisarati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Grupi i inspektimit verifikoi regjistrat ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisariateve të policisë në varësi të DVP Vlorë dhe konstatoi se zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës së viteve të kaluara lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore.

Në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, ndodheshin të gjithë regjistrat dhe librat e shërbimit që parashikohen në procedurën standarde.

Të gjithë librat e shërbimit e regjistrat ishin të regjistruar me numër fletësh në sekretari dhe të vulosur, dhe pas përfundimit të tyre ato dorëzoheshin po në sekretarinë e institucionit, për t'i ruajtur sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 (dy) persona në cilësinë e të arrestuarve.

Grupi i inspektimit intervistoi personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë. Nga intervistimi rezultoi se ata ishin të pajisur me setin e dokumenteve që duhet të mbahet prej tyre si kopje të urdhër ndalim/arrestimit, procesverbali për dorëzimin e sendeve personale, si dhe letra me të drejtat e këtyre personave.

Personat e arrestuar nuk paraqitën asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë procesit të marrjes në pyetje, si dhe punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë.

Nga verifikimi i librit të ankesave dhe kërkesave, u evidentua se nuk kishte asnjë ankesë apo pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë.

Nga intervistimi i të arrestuarve dhe informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që kryenin shërbim në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, ndërsa të miturit deri në katër vakte.

⁷ Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

Në dhomat e sigurisë të komisarariatit në Vlorë mungon ambienti i ajrimit për personat e ndaluar/të arrestuar që të mund të kalojnë të paktën 2 orë në ditë në ambient të hapur, sikurse është e përcaktuar në procedurën standarde⁸, duke sjellë si pasojë cenimin e një të drejte ligjore për këta persona.

Gjithashtu, nga intervistat me personat e arrestuar që ndodheshin në momentin e inspektimit, u evidentua se ata ishin furnizuar me detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen pastër të higjienës personale, ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Ambientet e intervistimit

Nga inspektimi i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarariatin e Policisë Vlorë, rezultoi se **mungonte dhoma e marrjes në pyetje/intervistimit** më vete, si për personat e shoqëruar dhe për personat e ndaluar/arrestuar, kur ata ndodhen për arsye shoqërimi apo si të dyshuar për vepra penale, në mjediset e këtij komisarati.

Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të kalonin nga ambienti i shoqërimit për në ambientin e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk plotësonin kushtet dhe kriteret e nevojshme, pasi ato duhet të jenë të pajisura me orënditë e nevojshme dhe të monitoruara nga sistemi i kamerave audio-vizive.

Gjatë inspektimit u vizituan zyrat e punonjësve të policisë, që kryenin veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar dhe nuk u gjetën pajisje prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat në kohën e intervistimit të tyre.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Përgjatë inspektimit u konstatua se ishte një listë e afishuar në ambientet e komisarariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht e përditësuar nga organi i prokurorisë. Punonjësit e policisë na bënë me dije se, avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Vlorë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu ishte i punësuar me kohë të plotë në DVP Vlorë.

Gjithashtu, kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit të Parandalimit të Torturës (KPT) në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohet gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese*

⁸ Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde thuhet shprehimisht se: “Ajrimi kryhet në mjediset të caktuara brenda sistemit të ambienteve të dhomave të sigurisë, në një vend të ndërtuar posaçërisht (dhomat e ajrimit)..... Koha e qëndrimit në ajrim është jo më pak se dy orë në ditë.”

*të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t'i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati*⁹. Avokati i Popullit thekson se është e një rëndësie të veçantë afishimi në ambientin e shoqërimit të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i arrestuari/ndaluar nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatë mbrojtës.

Gjatë inspektimit u konstatua se, brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar kartat me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë, si dhe të personave të ndaluar/arrestuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Në ligjin e ri *“Për Policinë e Shtetit”*¹⁰ përcaktohet se afati maksimal i shoqërimit është **5 orë**. Afishimi i këtyre kartave ndihmon në rritjen e transparencës dhe ndihmon qytetarët të kuptojnë se si të mbrojnë të drejtat e tyre gjatë interaksionit me policinë. Duke qenë se ky është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit mes publikut dhe institucioneve të rendit, me miratimin e ligjit të ri dhe ndryshimeve që ka sjellë do duhet zëvendësimi i tyre sa më i shpejtë me postera të rinj.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 6 të nenit 19 të ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për ndërtimin sa më parë në Komisaratin e Policisë Vlorë të ambientit të ri të dhomave të sigurisë, sipas kushteve e kriterëve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare, me qëllim shtimin e numrit të dhomave të sigurisë, rritjen e kapaciteteve akomoduese për të ndaluar/arrestuarit dhe përmirësimin e kushteve e trajtimin dinjitoz të këtyre personave dhe shmangien e mbipopullimit në këto ambiente.
2. Marrjen e masave për përshtatjen e një dhome më vete brenda sistemit të dhomave të sigurisë, për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar, e cila të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive.

⁹ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

¹⁰ Ligji i ri nr.82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, i cili ka hyrë në fuqi në datë 23.08.2024.

3. Marrjen e masave për ndërtimin e dritareve me përmasa e duhura referuar procedurës standarde, që të mundësonjë ajrim dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm për shikim dhe lexim të ndaluar/arrestuarve.
4. Marrjen e masave për, instalimin e butonave/zileve në dhomat e sigurisë ekzistuese, për njoftimin e personelit të shërbimit në rast nevojë nga personat e ndaluar/arrestuar.
5. Marrjen e masave për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit dhe sigurisë për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. Marrjen e masave për lysterjen, dezinfektimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të sigurisë në mënyrë të vazhdueshme.
7. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti brenda sistemit të dhomave të sigurisë, i cili të shërbejë si vend i posaçëm ajrimi për të ndaluarit/arrestuarit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI**

d.v